

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
me gjyqtarin Ilir Bytyqi dhe me sekretaren ligjore Adelina Sallahu, në çështjen penale kundër të akuzuarit G.K. nga Fsh. K. Ferizajt, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1745-7/16 te dt. 21.12.2016, pas mbajtjes së seancë së shqyrtimit fillestar publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – prokurorit, Ismet Rrahmani, të dëmtuarve N.A. dhe Y.A., si dhe të akuzuarit G.K. dhe av. mbrojtës B.S., me dt. 12 Janar 2017 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me dt. 23 Janar 2017 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Te akuzuari: G.K. data e lindjes...., nga i ati F. dhe e ëma R. e gjinisë Z., me vendbanim në Fsh. K. Ferizaj, i gjendjes së mesme ekonomike, ka te kryer shkollën e mesme, me profesion puntor fizik, i pamartuar, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 27.09.2019, rreth orës 17:20, në Fshatin slivove K. Ferizaj, i pandehuri duke drejtuar automjetin e markës “Peugeot” ngjyre e kaltër, me targa të regjistrimit, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 53/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia, ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, ne atë mënyrë qe duke mos përshtate shpejtësinë e lëvizjes kushteve ne rruge gjere sa ishte duke lëvizur prej drejtimit te Fshatit Slivovë ne drejtim te magjistrales Ferizaj-Shtime, përkatësisht në afërsi te Xhamise te Fshatit Slivovë, per shkak te shpejtësisë e humb kontrollin ndaj timonit dhe kalon në drejtim të kundërt te qarkullimit ne anën e majte dhe i godet këmbësoret te cilët kanë gene duke lëvizur ne anën e kundër te rrugës shikuar ne

drejtim te lëvizjes, ku nga forca e goditjes këmbësorja tani e ndjera E.A. hedhet jashtë rruge ndërsa këmbësorja tjetër Y.A. po ashtu hedhet jashtë rruge, ndërsa i pandehuri kalon ne anën e djathte te rrugës shikuar ne drejtim te lëvizjes duke u sjelle ne rruge dhe ne funde ndalet jashtë rruge ne anën e majte ne drejtim te Fshatit Slivovë, ku nga kjo goditje e dëmtuara tani e ndjera E.A. ndërron jete ne QKUK-Prishtine, kurse e dëmtuara Y. A. ka pësuar lëndime te lehta trupore me pasoja te përkohshme për shëndetin te përshkruar ne ekspertizën mjeko-ligjore te dt. 01.11.2016.

me të cilën kreu veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par. 6 të KPRK-së.

Andaj, në bazë nenit 378 dhe neneve 4, 7, 17, 23, 41, 42, 43, 45, 73, 74, 75, 76 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-së, e

G J Y K O N

- **ME DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 1/një/ Vit e 5 /pese/ Muaj, të cilin dënim do ta vuaj pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcenim te ekzekutimit me dhunë.**
- **Gjykata, konform nenit 62 dhe 67 par. 1 dhe 2 te KPRK-së, i shqipton dënim plotësues ndalim i ushtrimit te automjetit/veturës për 3 /tre/ Vite, pasi i pandehuri te vuaj dënimin.**
- **Të dëmtuarit, përfaqësuesi i te ndjerës E.A., bashkëshorti N.A. si dhe e dëmtuara Y.A. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.**
- **Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale (ekspertizës së komunikacionit dhe ekspertizën mjeko-ligjore) të paguaj shumën prej 60.88 € /gjashtëdhjetë euro e**

tetëdhjetë e tete cent/, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin të ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studio materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është ne juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territorial te kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar të pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën të evidentuar PP.nr.1749-7/16 te dt. 21.12.2016, ka ngarkuar të akuzuarin G.K., për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par. 6 të KPRK-së, si dhe gjate shqyrtimin fillestar ka mbetur në tërsi pranë aktit akuzues, duke kërkuar që të pandehurit të shpallet fajtorë dhe të ju shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj dhe ti ndaloj drejtimin e automjetit te pandehurit.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 12 Janar 2016, në të cilën shqyrtim fillestari akuzuari është deklaruar: *ndihem fajtor për veprën penale sipas te gjitha pikave te akuzës qe ngarkon, shprehi pendimin te thellë për veprën penale të kryer, andaj i kërkoj falje publike familjes së të dëmtuarve, premtoj gjykatës se ne te ardhmen nuk do te përsëritet, luti gjykatën të me shqiptoj një dënim sa më të butë.*

Mbrojtësi i të pandehurit Av. B.S. duke shprehur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i njëjti deklaron: vlerëson se pranimi i fajësisë nga ana e të mbrojturit është bërë në harmoni me dispozitat ligjore komfor nenit 248 par. 1 pika 1.1, 1.2, 1.3, dhe 1.4, te KPRK-se, këtë vepër penale e ka kryer nga pakujdesia dhe gjendja e tensionuar psicike si pasoj ne saje te cilit i vëllai i tij pak minuta me pare ka patur një aksident trafiku ne afërsi rreth 200 metra larg aksidentit te shkaktuar nga i pandehuri, për faktin se i pandehuri ka pranuar nje thirrje nga nje person se vëllai i tij ka pësuar ne aksident dhe me nguti i pandehuri merre automjetin dhe ne gjendje te tendosur psiqike tenton te shkoje te aksidenti ku ishte i vëllai. Lusim gjykatën ti merre parasysh rrethanat veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë, rrethanat lehtësuese

bashkëpunimin me gjykatën, sjelljen korrekte pas aksidentit, pendimin e thellë për veprën penale të cilën e ka kryer, duke i propozuar Gjykatës që të pandehurit ti shqiptoj një sanksion penal sa më të butë.

Përfaqësuesi i te ndjerës E.A., bashkëshorti N.A. duke shprehur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i njëjti deklaron: këtë qeshtje penale i le të vendos gjykatës ne baze të ligjit, ndërsa kërkesën pasurore juridike do ta paraqesim në procedurë juridiko-civile.

E dëmtuara Y.A. duke shprehur mendimin e saj lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaron: këtë qeshtje penale i le të vendos gjykatës ne baze të ligjit, ndërsa kërkesën pasurore juridike do ta paraqesim në procedurë juridiko-civile.

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që gjatë matjes së denimit ti ketë parasysht si rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligj.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysht edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 të KPP-së dhe me këtë rast vlerësoi se:

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit gjatë procedurës para penale dhe në shqyrtimin fillestar, ekspertizen mjeko-ligjore dt. 01.11.2016, ekspertizën e inxhinierit të komunikacionit e dt. 15-16.10.2016, certifikatën e vdekjes e dt. 05.10.2016, deklaratat e të dëmtuarve N.A. dhe Y.A., raporti i aksidentit nr. 2016-CFT-600 e dt. 27.09.2019, si dhe fotografit të cilat gjenden në shkresat e lendes, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 të KPRK-së, meqë i akuzuari në vend, datë dhe kohë e përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi, duke drejtuar automjetin e markës “Peugeot” me targa të regjistrimit, duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 53/1 të LSKRR-së, nga pakujdesia, ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke mos përshtatë shpejtësinë e lëvizjes kushteve në rrugë gjere sa ishte duke lëvizur prej drejtimit të Fshatit Slivove në drejtim të magjistrales Ferizaj-Shtime, humb kontrollin ndaj timonit dhe kalon në anën kundërt të drejtimit të lëvizjes dhe i godet këmbësoret të cilët kanë qene duke lëvizur në anën e kundër të rrugës shikuar në drejtim të lëvizjes, ku nga forca e goditjes këmbësoret E.A. dhe Y.A. i hedhe jashtë rrugë, ku nga kjo goditje e dëmtuara tani e ndjera E.A. ndërron jete në QKUK-Prishtinë, kurse e dëmtuara Y. A. ka pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin të përshkruar në ekspertizën mjeko-ligjore të dt. 01.11.2016.

Me qenë se i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj trupi gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPP-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73,74 dhe 75 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, kurse si rrethana lehtësuese, pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, i moshës e re, më parë nuk ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë kurse në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale që për pasojë ka marrë jetën e një personi.

Gjykata është e bindur se edhe me aplikimin e institutit të zbutjes së dënimit, në kuptim të nenit 75 dhe 76 të KPRK-së, edhe me anë të këtij dënimi është e pritshme të arrihet qëllimi i

përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, duke u nisur nga fakti se i akuzuari ka pranuar fajësinë dhe dënim ky që është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, rrethanat e kryerjes, si edhe me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjeneralë).

Gjykata, Të dëmtuarit, perfaqesuesi i te ndjeres E.A., bashkeshorti N.A. si dhe e demtuara Y.A. për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPPK-së, obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale (ekspertizës së komunikacionit dhe ekspertizën mjeko-ligjore) të paguaj shumën prej 60.88 € /gjashtedhjetë euro e tetedhjet e tete cent/, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin të ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,

P.nr.1176/14 data. 23.01.2017

**Sekretarja Juridike,
Mimoza Shabani**

**Gjyqtari Individual
Ilir BYTYQI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.